



**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL  
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE  
TË LËNDËS MATEMATIKË  
2022**

**1. HYRJE**

Mësuesi është faktori më i rëndësishëm në përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Një mësuesi, për të qenë i aftë në punën e tij, nuk i duhet të zotërojë vetëm lëndën, por edhe të dijë ta transmetojë atë sa më lehtësisht te nxënësi, nëpërmjet metodologjive bashkëkohore. Mësuesit veprojnë me ndershmëri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, por në të njëjtën kohë përditësojnë njohuritë nëpërmjet vetëvlerësimeve të vazhdueshme, krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe punojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së matematikës është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së matematikës në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit, si dhe të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentacioni zyrtar<sup>1</sup> shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve në shkollë;
- programe lëndore të matematikës;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në procesin mësimdhënie – nxënie të lëndës së matematikës;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;

<sup>1</sup> Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore të matematikës.

## 2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së matematikës në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve, ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DRAP-et, ZVAP-të, përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

### *Programi synon që mësuesi:*

- njeh dhe zbaton legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore;
- zotëron kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- demonstron aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- tregon përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë dhe në jetën reale, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- njeh konceptin e gjithëpërfshirjes dhe demonstron përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- demonstron zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- zotëron zbatimin e rregullave drejtshkimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie – nxënies;
- përdor aftësitë e TIK-ut në procesin mësimor, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien me kompetenca.

### 3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të përcaktuar. Për secilën fushë, përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;
- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe i aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqëndrohet.

<b>FUSHA “DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR”</b>	
<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi me përgjegjshmëri i</b> <b>kërkesave të legjislacionit dhe</b> <b>dokumentacionit shkollor”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i matematikës:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>• zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.</li><li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li><li>• zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li><li>• demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies;</li><li>• zbaton etikën profesionale të</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li><li>• Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020</li><li>• Udhëzimi nr.17 “Për fillimin e vitit shkollor 2021-2022 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS (16.08 2021).</li><li>• Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar me Udhëzimin nr.14, date 28.7.2021</li><li>• Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të</li></ul>

<p>mësuesit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>• respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>• zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<p>zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzimi nr. 4, datë 26.02.2021. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”.</li> <li>• Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.</li> <li>• Urdhri Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”.</li> <li>• Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> </ul>
--	---

<b>FUSHA “PROGRAME LËNDORE TË MATEMATIKËS”</b>	
<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të matematikës në shkollë”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i matematikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij;</li> <li>• përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;</li> <li>• përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;</li> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza kurrikulare, 2014.</li> <li>• Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014.</li> <li>• Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016.</li> <li>• Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -XII.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;</li> <li>• harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e programit;</li> <li>• kategorizon rezultatet e të nxënit e programit sipas niveleve të arritjes së të nxënit;</li> <li>• tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të matematikës);</li> <li>• përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit;</li> <li>• siguron informacion që demonstroi lidhjen e matematikës me shkencat e tjera dhe me jetën reale.</li> </ul>	
---	--

**FUSHA “ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE”**

<p style="text-align: center;"><b>Kompetenca I</b></p> <p style="text-align: center;"><b>“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e matematikës”</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i matematikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;</li> <li>• përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;</li> <li>• demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;</li> <li>• identifikoi nxënësit me nevojat e veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.</li> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017</li> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016.</li> <li>• Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, ASCAP (ish IZHA) 2018.</li> </ul>

<p>e talentuar);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• planifikon punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;</li> <li>• demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe lëndës së matematikës;</li> <li>• edukon të nxënësit dashurinë dhe kërkueshmëri ndaj lëndës së matematikës;</li> <li>• motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;</li> <li>• krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>• punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së matematikës në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018.</li> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së matematikës në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.</li> </ul>
<p><b>Kompetenca II</b>  <b>“Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e matematikës”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b>  <i>Mësuesi i matematikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objektivi të caktuar;</li> <li>• përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;</li> <li>• planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;</li> <li>• përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;</li> <li>• përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;</li> <li>• përdor proceset matematike në mësimdhënien – nxënien e matematikës;</li> <li>• demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;</li> <li>• shpjegon parimet e hartimit të një testi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017</li> <li>• Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz, 2016.</li> <li>• Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA (sot ASCAP) 2016.</li> <li>• Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA (sot ASCAP) 2018.</li> <li>• Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), Shtator 2019.</li> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës</li> </ul>

	<p>së matematikës në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së matematikës në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.</li> <li>• Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), ASCAP 2020 Lënda: matematikë.</li> <li>• Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP 2021, Lënda: matematikë.</li> </ul>
<p><b>Kompetenca III</b>  <b>“Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në matematikë”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b>  <i>Mësuesi i matematikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• prezanton materiale matematikore duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Poëer Point, Excel, Math Type në Ëord;</li> <li>• nxit nxënësit të bëjnë prezantime në matematikë duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta;</li> <li>• gjen dhe përdor materiale nga ëebsite për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien;</li> <li>• përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së matematikës apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga ëebsite.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së matematikës që përdoren në klasat VI - IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X - XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.</li> <li>• Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021.</li> <li>• Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021</li> </ul>

<b>FUSHA “ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT”</b>	
<b>Kompetenca</b>	<b>Literatura</b>
<b>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</b>	
<b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i matematikës:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>njuh rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”</li> </ul>

<b>FUSHA “ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE”</b>	
<b>Kompetenca</b>	<b>Literatura</b>
<b>“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe”</b>	
<b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i matematikës:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>njuh rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe;</li> <li>demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>

<b>FUSHA “PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS”</b>	
<b>Kompetenca</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<b>“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së matematikës”</b>	
<b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i matematikës:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>dallon konceptet dhe shprehjet kryesore me të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Programe dhe tekste të lëndës së matematikës për mësuesin dhe</li> </ul>



<p>cilat operon lënda e matematikës në klasat VI-IX dhe X-XII;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve matematikore në klasat VI-IX dhe X-XII;</li> <li>• përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe shprehive;</li> <li>• dallon ndërvarësinë e koncepteve matematikore nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;</li> <li>• zgjidh me saktësi dhe me mënyra të ndryshme situata problemore matematike të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve në klasat VI-IX dhe X-XII;</li> <li>• përdor informacion të saktë e bindës për vlerat përdoruese të matematikës në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme.</li> </ul>	<p>nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.</p>
---	---